

SHABAN DEMIRAJ NJË PERSONALITET ME KONTRIBUTE TË ÇMUARA DHE TË SHUMANSHME PËR GJUHËN SHQIPE DHE GJUHËSINË SHQIPTARE

SHABAN DEMIRAJ A PERSONALITY WITH VALUABLE CONTRIBUTIONS TO THE STANDARDIZATION OF LANGUAGE AND SCIENCE IN ALBANIA

BUKUROSHË ISUFAJ

Departamenti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Vlorës, Vlorë, ALBANIA

E-mail: bukuroshe_isufaj@yahoo.it

AKTET VI, 4: 390 - 394, 2013

PERMBLEDHJE

Kontributi i dijetarit e poliglotit Shaban Demiraj në shkencën e gjuhësisë shqiptare ka hyrë në fondin e artë të kulturës kombëtare shqiptare, si një nga studiuesit më të mëdhenj e me kontribut të veçantë si në fushën e studimeve albanologjike, ashtu dhe në ato ballkanistike, duke mbajtur autorësinë e një vargu veprash shkencore. Mbi të gjitha janë të rëndësishme veprat: *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (1961), *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe* (1972), *Prejardhja e shqiptarëve nën dritën e dëshmimeve të gjuhës shqipe* (1999), *Epiri, pellazgët, etruskët, mesapët dhe shqiptarët* (2008). Ndihej në akademik Shaban Demiraj për standardizimin e shqipes në këtë studim e shohim në dy drejtime kryesore, njësoj të rëndësishme: punën që ai bëri me mjetet kodifikuese të standardizimit të shqipes; dhe aktivitetin që zhvilloi në kumtesa e referate, të lexuar në konferenca shkencore për standardizimin e gjuhës shqipe e përsosjen e mëtejshme të normave të saj.

Fjalët çelës: kontribut, gjuhësi, studime, dialektologji, standardizim.

SUMMARY

The contribution of the scientist and polyglot Shaban Demiraj in the Albanian linguistic field has become part of the golden fund of the Albanian national culture. He is one of the greatest scholars with a special contribution, to the Albanian studies in general and in Balkan studies in particular. I would like to mention few of his most influential scientific works like: "Morphology of today's Albanian language" 1961; "Nominal system issue of the Albanian language" 1972; "The origin of Albanians in the light of Albanian language evidence" 1999; or recently "Epirus, Pelasgians, Etruscans, Mesap and Albanians" 2008 and many other works. We find the assistance of Shaban Demiraj on the standardization of Albanian language in two main directions, equally important: primarily with the work he did with codification tools of standardizing the Albanian language and secondly the activity developed in the papers and reports read at scientific meetings to standardize the Albanian language and further perfection of it

Key words: contribution, linguistics, Shaban Demiraj, activities, studies, dialectology, standardization

Hyrje

Shaban Demiraj është një figurë e veçantë e albanologjisë dhe e shkencës gjuhësore shqiptare. Vepra e tij dëshmon për një personalitet shkencor me erudicion të rrallë, i cili ka zënë një vend të nderuar në shkencën tonë gjuhësore krahas emrave të tjerë të mirënjohur

si: Aleksandër Xhuvani, Kostaq Cipo, Eqrem Çabej, Mahir Domi, Selman Riza, Idriz Ajeti, Martin Camaj. Kontributet e tij shkencore janë të shumanshme, por ai shquhet veçanërisht në fushën e gramatikës së shqipes së sotme dhe në gjuhësinë historike.

Pati fatin të ishte student i emrave të mëdhenj si: A. Xhuvani, K. Cipo, E. Çabej, të cilët patën ndikim vendimtar në të ardhmen e tij si studiues. Prej tyre ai do të përfitonte jo vetëm dijet shkencore albanologjike në nivelin më të lartë të kohës, por edhe metodën e arsytimit e të kërkimit shkencor të pavarur, mënyrën e vështrimit e të trajtimit të dukurive gjuhësore, si dhe etikën e intelektualit, që e çmon dinjitetin njerëzor si vlerë morale themelore.

Hartues tekstesh themelore për shkollën e lartë

Jeta dhe vepra e prof. Sh. Demirajt flet për një dashuri të veçantë ndaj gjuhës shqipe, ndaj gjuhëve e gjuhësisë në përgjithësi, për pasionin, durimin e këmbënguljen shembullore në rrugën e kërkuesit e të shkencëtarit të palodhur dhe të mësuesit të brezave.

Falë punës këmbëngulëse e sistematike ky dijetar i madh ka dhënë një mal me vepra të vyera e me rëndësi themelore në shumë fusha: në gramatikën e gjuhës së sotme shqipe, në historinë e gjuhës letrare, në studimet arbëreshe, në ballkanologji, në arsimin kombëtar.

Duke i vështruar me vëmendje interesin dhe pasionin e tij për të vjelë të dhëna me vlerë për studime gjuhësore dhe historike, vërejmë se Shaban Demiraj studimet e veta shkencore i shtrin në disa disiplina të shkencave filologjike. Si rezultat i hulumtimeve sistematike që ka bërë për autorët arbëreshë të Italisë dhe për autorët e Rilindjes të shekullit XIX botoi dispensën *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, e cila, për nga vlerat që mbartte, pati një rëndësi të dyfishtë, nga njëra anë ishte një ndër veprat e rralla e me mjaft rëndësi për shkencat albanologjike në fushën e historisë së gjuhës së shkruar për periudhën kohore të shek. XIX dhe, në anën tjetër, sepse pasuronte formimin universitar të studentëve me një lëndë të re shumë të nevojshme.

Në vitet e para të veprimtarisë së vet si profesor në Institutin e Lartë Pedagogjik, Sh. Demiraj edhe për nevoja të studentëve hartoi një dispensë të *Fonetikës dhe të leksikologjisë së gjuhës shqipe*. Duke zhvilluar lëndën e morfologjisë së shqipes së sotme në Fakultetin e Histori-Filologjisë, ai botoi tekstin universitar të saj me bazë të fortë

shkencore. Kjo vepër për nga vlerat dhe mbështetja shkencore shënon nivelin më të lartë të përpunimit të gjeratëhershëm të kategorive gramatikore dhe të normës letrare në fushën e morfologjisë së gjuhës shqipe. Vepra mbështetet mbi vëzhgime të pasura të autorit nga gjuha e folklorit dhe e letërsisë shqipe.

Krahas tekstit *Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe* (1960), Shaban Demiraj botoi vijimiisht në revistën *Studime filologjike* një varg artikujsh e punimesh nga fusha e gramatikës së gjuhës shqipe: për sistemin emëror (gjininë asnjane, emrat ambigjenë, shumësin e emrave, kategoritë e shquarsisë) dhe për sistemin foljor (zgjedhimin e foljeve, kuptimet e kohëve të mënyrës dëftore, habitore, diatezat e foljeve). Ato do të shërbejnë si gurë themeli për veprën kolektive *Gramatika e gjuhës shqipe* (1976, 1995) të Akademisë të Shkencave të Shqipërisë, në të cilën prof. Demiraj është redaktor i vëll. II, "Morfologjia".

Studimet në fushën e gramatikës historike të shqipes

Shaban Demiraj ka bërë studime të vlefshme edhe në fushë të gramatikës historike të gjuhës shqipe. Në vitet 1973-1976 botoi tekstin *Morfologjia historike e gjuhës shqipe* në dy pjesë, që shënon një hap të ri përpara në këtë fushë në krahasim me tekstet e mëparshme të hartuara nga prof. Mahir Domi e prof. Idriz Ajeti. Më 1986 botoi veprën e vëllimshme *Gramatikë historike e gjuhës shqipe* (1166 faqe), që është në thelb një enciklopedi e vërtetë e evolucionit të strukturës gramatikore të gjuhës shqipe. Vepra është parashtrim analitik i arritjeve të tij në këtë fushë, ku janë shpalosur jo vetëm dijet e tij të gjera për punën e kryer nga paraardhësit, por edhe ide e teza origjinale me argumentim të qëndrueshëm. Kjo gramatikë është një vepër monumentale e fondit të artë të literaturës sonë gjuhësore. Një version i shkurtuar i saj është botuar gjermanisht nga Akademia e Shkencave e Vjenës (1993) dhe është bërë një libër konsultimi për albanologët dhe studiuesit e shqipes në vende të ndryshme të botës.

Një vepër tjetër themelore e prof. Sh. Demirajt është *Gjuha shqipe dhe historia e saj* (1988), e

cila përbën një sintezë të rrugës historike të zhvillimit të gjuhës shqipe që nga periudha indoeuropiane e saj deri në ditët tona. Në këtë vepër trajtohn çështje të tilla, si vendi i shqipes në rrethin e gjuhëve indoeuropiane, tiparet e shqipes si gjuhë ballkanike, karakteristikat themelore të strukturës gramatikore të shqipes, prejardhja e shqipes, marrëdhëniet e shqipes me gjuhët fqinje, ndarja dialektore e shqipes dhe lëvrimi i saj.

Demiraj ka botuar edhe një numër artikujsh të posaçëm për studiues të veçantë të gjuhës shqipe, si për Sami Frashërin, Gjergj Fishtën, Aleksandër Xhuvanin, Mahir Domin, Selman Rizën, Franc Mikloshicin, Norbert Joklin, por mbi të gjitha për mësuesin e tij, prof. E. Çabejnë, botoi një studim të plotë monografik. Ndërkaq në vitin 1978, Demiraj bashkë me historianin Kristaq Prifti, botuan monografinë *Kongresi i Manastirit ngjarje me rëndësi në lëvizjen kombëtare shqiptare*, që është ribotuar e plotësuar dhe e zgjeruar më 2004.

Kumtesa e referate

Një kontribut të madh ka dhënë prof. Sh. Demiraj me kumtesat e referatet në tribuna shkencore kombëtare, ballkanike e ndërkombëtare. Ai ka marrë pjesë në shumë veprimtari shkencore të organizuara në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni, te Arbëreshët e Italisë dhe në kongrese të studimeve ballkanike.

Në Kongresin e Drejtëshkrimit të Gjuhës Shqipe (1972) Shaban Demiraj në kumtesën e vet e vinte theksin mbi domosdoshmërinë për kodifikimin përfundimtar të rregullave të drejtshkrimit të shqipes, duke i konsideruar të domosdoshme edhe fushat e veprimit të parimeve të tjera, të cilat ndihmonin parimin themelor (parimin fonetik), sidomos sa i përket parimit morfologjik, për t'i ruajtur sa më të plota trajtat e fjalëve dhe morfemat e tyre.

Studimi i dialekteve të shqipes dhe i të folmeve të Arbëreshëve të Italisë

Shaban Demiraj edhe pse nuk është marrë drejtpërdrejt me studimin e dialekteve të shqipes, u është qasur e referuar dendur të

dhënave të dialekteve të shqipes, sepse ato janë një burim me vlerë si për gjuhën e sotme, ashtu edhe për gramatikën e fonetikën historike. Në mënyrë të veçantë, ai u është referuar të dhënave të të folmeve arbëreshe të Italisë e të Greqisë, si dhe gjuhës së disa prej autorëve më të njohur të letërsisë arbëreshe, sidomos veprës së Jul Varibobës *Gjella e Shën Mërisë virgjër* dhe të Gavril Darës së Ri *Kënga e sprasme e Balës*.

Lidhur me të folmet arbëreshe ai vëren se *“ato ruajnë ende disa tipare të shqipes a arbërishtes së kohës së mesme, që me kalimin e kohës ose janë zhdukur fare në të folmet e Shqipërisë ose janë ruajtur pjesërisht në ndonjë nëndialekt konservator, siç është çamërishtja/.../ janë ruajtur një numër fjalësh të vjetra, që në të folmet e Shqipërisë ose janë zhdukur fare, ose hasen aty-këtu në ndonjë të folme anësore.”* Në fushën e leksikut dallon arkaizma leksikore si: *delmer, përderës, gjegj, m’u ndot “m’u duk” etj.* dhe arkaizma kup-timorë: *gjellë, “botë” = dhe, “tokë”, ndëlkonj = “kuptoj”, cel = “ndez”, çonj = “gjej”.* Si tipare arkaike në sistemin fonetik të tyre rendit: 1) Ruajtjen e grupeve të bashkëtingëlloreve **kl, gl** në disa të folme, si p.sh. në ato të Sicilisë; 2) Ruajtjen e tingullit **l** në fjalë si *bilë, golë*. Ndërsa për sa u takon formave gramatikore përmend rrjedhoren e shquar shumë me mbaresën **-shit: turqëshit;** apo të ashtuquajturën rasë vendore: *ndë dhet, ndë kamaret*. Vëren si karakteristikë sintaksore të përdorurit e rasës rrjedhore pa parafjalë më shumë se në shqipen e sotme (*u ngre Kostantini varrit; Vashën e dua t’Arbëreshë gluhje e zakonë-shi*).

Në kohën kur u shkrua teksti i Shaban Demiraj *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, nuk ishin kryer ende shumë nga ato kërkime e studime që do të merrnin më vonë studiuesit arbëreshë e shqiptarë, si dhe albanologë të huaj, nuk ishin kryer ende gjithë ato hulumtime në terren nga dialektologë arbëreshë e shqiptarë. Prandaj vlera e këtij teksti del edhe më e madhe, po të shihet lidhur me kohën kur u hartua.

Studimi krahasues i shqipes në kontekst ballkanik

Dihet se gjuhët që fliten në Ballkan, veçanërisht shqipja, rumanishtja e arumanishtja, bullgarishtja, maqedonishtja, greqishtja, përveç tipareve të përbashkëta indoeuropiane, kanë edhe disa tipare karakteristike që janë zhvilluar në mjedisin ballkanik. Këto tipare kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve dhe me kohë u krijua edhe një drejtim i ri studimesh që u quajt gjuhësi ballkanike. Në këtë kuadër edhe interesimi i studiuesve shqiptarë nuk ka munguar. Figura të njohura të gjuhësisë sonë, si Dh. Kamarda, Gj. Pekmezi, A. Xhuvani, E. Çabej, M. Domi, I. Ajeti etj. kanë sjellë herë pas here kontribute me vlerë në këtë fushë. Por Sh. Demiraj është i pari që botoi një vepër sintetike *Gjuhësia ballkanike* (1994), duke e vështruar këtë drejtim studimesh sidomos nga pozitativet e shqipes. Te kjo vepër ai arriti pas një vargu ndihmesash të veçanta sidomos nëpër konferenca ndërkombëtare, ku ka trajtuar çështje të sistemit të nyjave në shqipe krahasuar me rumanishten, vendin e përcaktorëve në përfaqje me gjuhët romane, dukuri të ndryshme gjuhësore ballkanike në shqipe dhe bashkëpërkime morfo-sintaksore midis shqipes dhe rumanishtes etj.

Etnogjeneza e shqiptarëve

Një kontribut të vyer prof. Shaban Demiraj ka dhënë edhe lidhur me etnogjenezën e shqiptarëve, me burimin e gjuhës shqipe, me lidhjet e saj me gjuhët e tjera fqinje. Po veçojmë ndihmesën e tij në argumentimin e autoktonisë së shqiptarëve përmes analizës gjuhësore të emrave të vendeve dhe emrave vetjakë të kohës ilire. Me forcën e faktit dhe mprehtësinë e argumentit e të analizës ai ka dhënë ndihmesë të vyer e të pazëvendësueshme për etnogjenezën e shqiptarëve përmes onomastikës dhe toponomastikës. Këto çështje i ka trajtuar në artikuj e vepra të ndryshme të tij, por u ka kushtuar vitet e fundit edhe një vepër sintetike *Epiri, Pellazgët, Etruskët dhe Shqiptarët* (2008).

Puna e Prof. Sh. Demirajt ka sjellë përforcimin e argumentimeve se shqiptarët janë autoktonë në trojet ku jetojnë sot, janë pasardhës të fiseve ilire që kanë banuar në to. Ai ka theksuar se pa një

bashkëpunim ndërdisiplinor, është e pamundur që çështje si origjina e popullit shqiptar, koha dhe vendi i formimit të tij, të sqarohen në mënyrë sa më të argumentuar, ndaj, në punimet e veta profesori ka gërshetuar me mjeshtëri, profesionalizëm dhe me frytshmëri të lartë studimet gjuhësore e krahasuese me të dhënat historike, etnografike, gjeografike, arkeologjike.

Përfundim

Akademik Sh. Demiraj është personalitet i kulturës dhe shkencës sonë, me një jetë të tërë të mbushur me studim, me kërkim, me krijimtari mbi baza të qëndrueshme shkencore, duke na bërë të ndihemi krenarë me veprën e tij.

Në përfundim të kësaj përpjekje modeste për të vlerësuar kontributin e çmuar të prof. Demirajt në zhvillimin e gjuhësisë shqiptare mund të themi se emri i tij si mësues, si profesor e shkencëtar është i mirënjohur jo vetëm në hapësirën shqiptare, po edhe më gjerë, në botën shkencore albanologjike. Ai është një nga gjuhëtarët shqiptarë më prodhues e me më shumë interesa. Kontributi i akademik Shaban Demirajt në arsimin dhe shkencën shqiptare është tepër i gjerë për t'u përshkruar në një kumtesë, sepse emri, studimet dhe vlera e veprës së tij janë ato të një kolosi, ndaj, krahas emrave të tjerë të ndritur, ai ka zënë një vend të nderuar në panteonin e kulturës shqiptare.

Bibliografia

- DEMIRAJ, Shaban (1968), Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Tiranë.
 DEMIRAJ, Shaban (1956), Leksikologjia dhe fonetika e gjuhës shqipe, Tiranë.
 DEMIRAJ, Shaban (1960), Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, Tiranë.
 DEMIRAJ, Shaban (1973, 1976), Morfologjia historike e gjuhës shqipe I, II, Tiranë.
 DEMIRAJ, Shaban (1986), Gramatika historike e gjuhës shqipe, Tiranë.
 DEMIRAJ, Shaban (1988), Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë.
 DEMIRAJ, Shaban (1990), Eqrem Çabej-një jetë kushtuar shkencës, Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban & PRIFTI, Kristaq (1978), Kongresi i Manastirit ngjarje e rën-dë-si-sh-me e Rilindjes Kombëtare, Tiranë.

DEMIRAJ-DODI (1972), Një kontribut për kristalizimin e normës së gjuhës letrare, Probleme të normës (I), Tiranë.

DEMIRAJ, Shaban (1974), Rreth disa çështjeve gramatikore të rregullave të drej-të-sh-k-ri-mit të gjuhës shqipe: Kongresi i Drejtëshkrimit të Gjuhës Shqipe, Prishtinë.

KONFERENCA SHKENCORE (2011), Akademik Shaban Demiraj dhe kontributi i tij në arsimin dhe shkencën shqiptare, Vlorë.